Shtojca 1. Formulari i Ofertës

Shtojca 2. Listat e Çmimeve të Shërbimeve

Shtojca 3. Formulari i Sigurimit të Ofertës

Shtojca 4. Lista e Informacionit Konfidencial

Shtojca 5. Formulari i Specifikimeve Teknike

Shtojca 6. Formulari i Shërbimeve dhe Grafikut të ekzekutimit

Shtojca 7. Formulari i Termave të Referencës

Shtojca 8. Formulari i Kritereve të Përzgjedhjes së Ofertuesve

Shtojca 9. Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit

Shtojca 10: Formulari i Njoftimit të skualifikimit

Shtojca 11: Formulari i Njoftimit të Fituesit

Formulari 12- Formulari i Njoftimit të Fituesit (Pas procesit të ankimit)

Shtojca 13: Formulari i Njoftimit të Operatorëve Ekonomikë të Suksesshëm në Marrëveshjen Kuadër

Shtojca 14: Formulari i Njoftimit të Operatorëve Ekonomikë të Suksesshëm në Marrëveshjen Kuadër (Pas procesit të ankimit)

Shtojca 1.

(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)

FORMULARI I OFERTËS

Data:

Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:

Për: **[Operatori Ekonomik shënon emrin e Autoritetit/Entit Kontraktor]**

Emri i ofertuesit dhe NIPT-i **[Operatori Ekonomik shënon emrin e ofertuesit dhe NIPT-in]**

Ne, të nënshkruarit, deklarojmë se:

- (a) Kemi konsultuar dhe nuk kemi asnjë rezervë për Dokumentet e Tenderit të procedurës me objekt:*[shënoni objektin e procedurës së prokurimit të publikuar në SPE]*, përfshirë sqarimet dhe Shtojcat e nxjerra.
- (b) Ne *[vendos emrin e Operatorit Ekonomik dhe numrin unik të identifikimit, dhe/ose anëtarët e BOE, nëse është rasti]*, nuk jemi në të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike dhe jemi në përputhje me kërkesat e kualifikimit dhe kërkesat specifike të kontratës siç specifikohet në njoftimin e kontratës *[vendos objektin e procedurës së prokurimit/lotit]*.
- (c) Ne ofrojmë të kryejmë për Autoritetin/Entin Kontraktor **[vendos emrin e Autoritetit/entit Kontraktor]**, në përputhje me Dokumentet e Tenderit (shih më poshtë), Shërbimet për **[vendosni CPV-në e procedurës/Lotit përkatës nga Njoftimi i Kontratës të publikuar në SPE]** në përputhje me Ofertën Teknike, me çmimet e renditura në Listën e Çmimeve të Artikujve dhe në përputhje me Termat dhe Kushtet e Kontratës, të cilat reflektohen në Dokumentet e Tenderit.
- (d) Oferta jonë është në përputhje me dokumentet e mëposhtme::
 - 1. Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë;
 - 2. Njoftimin e Kontratës;
 - 3. Kriteret e Përzgjedhjes;
 - 4. Specifikimet teknike, grafikun e ekzekutimit dhe termat e referencës;
 - 5. Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
 - 6. Kushtet e Veçanta të Kontratës;
 - 8. Listat e Çmimeve të Shërbimeve.
- (e) Çmimi total i Ofertës sonë, **pa TVSH**, është: ----- **[Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë];**
- (f) Çmimi total i Ofertës sonë, **me TVSH**, është: ----- **[Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë];**

Emri i përfaqësuesit të ofertuesit	
Nënshkrimi	
Vula	
Datë _____	

Shtojca 2.

(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)

LISTA E ÇMIMEVE TË SHËRBIMEVE**Data:** _____**Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:**
_____**Emri dhe numri unik i identifikimit të Operatorit Ekonomik/Operatorëve ekonomikë (në rast BOE):** _____**Monedha:** _____

Në rast të mospërputhjes midis çmimit për njësi dhe totalit, këto do të rregullohen në përputhje me Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Çmimet dhe monedhat të jenë në përputhje me Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Të gjithë artikujt në Formularin e Shërbimeve dhe grafikut të ekzekutimit duhet të hidhen dhe tu vendoset çmimi i ofruar në Listën përkatëse të Çmimeve për shërbimet. Shërbimetpa çmim do të konsiderohen si shërbime të paofruar dhe do të cojnë në refuzimin e ofertës.

Lista e Çmimeve

<i>1</i>	<i>2</i>	<i>3</i>	<i>4</i>	<i>6</i>	
Artikulli	Përshkrimi i shërbimit	Sasia per 48 Muaj	çmimi për njësi	Çmimi total për shërbim	Afati
1.	Shërbimi i lavanderisë dhe hotelerisë për Drejtorinë e Shërbimit Spitalor, Korçë	341,364			48 (dyzetë e tetë) Muaj.
Fondi i Marreveshjes Kuadër:				107,048,337	
Çmimi Neto pa TVSH					
TVSH (%)					
Çmimi total me TVSH:					
Emri i përfaqësuesit të ofertuesit					
Nënshkrimi					
Vula					
Datë _____					

Shtojca 3.

[*Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik*]
[*Letër me kokë e Bankës / Kompanisë së Sigurimeve*]

FORMULARI I SIGURIMIT TË OFERTËS

Për: [Emri dhe adresa e autoritetit/entit kontraktor]

Në emër të: [Emri dhe adresa e ofertuesit të siguruar]

* * *

Procedura e prokurimit [lloji i procedurës]

Përshkrim i shkurtër i kontratës: [objekti]

Publikimi (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]/Nr. Referencës në faqen e APP-se

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur,

Ne vërtetojmë se [emri i ofertuesit të siguruar] ka derdhur një depozitë pranë [emri dhe adresa e bankës] / është garantuar pranë [emri dhe adresa e kompanisë së sigurimit] me një vlerë prej [monedha dhe vlera, e shprehur në fjalë dhe shifra] si kusht për sigurimin e ofertës, dorëzuar nga operatori i lartpërmendur ekonomik.

Marrim përsipër të transferojmë në llogarinë e [emri i autoritetit/entit kontraktor] vlerën e siguruar, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga kërkesa juaj e thjeshtë dhe e parë me shkrim, pa kërkuar shpjegime, me kusht që kjo kërkesë të përmendë mospërbushjen e njërit nga kushtet e mëposhtme:

- Ofertuesi e ka tërhequr ose ka ndryshuar ofertën, pas afatit përfundimtar për paraqitjen e ofertave ose para afatit përfundimtar, nëse është përcaktuar kështu në dokumentat e tenderit;
- Ofertuesi ka refuzuar nënshkrimin e kontratës së prokurimit kur autoriteti/enti kontraktor e kërkon një gjë të tillë;
- Ofertuesi nuk ka paraqitur sigurimin e kontratës, ku oferta është shpallur fituese ose nuk ka plotësuar ndonjë kusht tjetër përpara nënshkrimit të kontratës së përcaktuar në dokumentat e tenderit.

Ky Sigurim është i vlefshëm për periudhën e specifikuar në [njoftimin e kontratës].

[Përfaqësuesi i bankës / kompanisë së sigurimit]

Shtojca 4.

(Shtojcë për tu paraqitur nga Operatori Ekonomik, nëse është rasti)

Lista e Informacionit Konfidencial

(Shkruani informacionin që dëshironi të mbetet konfidencial)

Lloji, natyra e informacionit që duhet mbajtur konfidencial	Numri i faqeve dhe pikave në DST që dëshironi të mbeten konfidenciale	Arsyet e mbajtjes konfidencial të këtij informacioni	Afati i fundit për mbajtjen konfidencial të këtij informacioni

VËMENDJE

Çdo e dhënë që nuk është regjistruar si konfidenciale do të konsiderohet se për të është dhënë pëlqimi i mbajtësit të një informacioni të tillë dhe Autoriteti/Enti Kontraktor nuk do të jetë përgjegjës për nxjerrjen e këtij informacioni.

Nuk konsiderohet se përbën sekret tregtar informacioni që duhet të bëhet publik sipas ligjit, që ka të bëjë me një shkelje të ligjit ose që duhet të publikohet në bazë të praktikave të mira tregtare dhe parimeve të etikës tregtare. Konkretisht: Operatori ekonomik nuk mund të klasifikojë si konfidencial: çmimin e ofertës, listën e çmimeve, katalogun, informacionin lidhur me kriteret e përzgjedhjes së ofertës, dokumentet publike, fragmente nga regjistrat publikë dhe informacione të tjera që duhet të bëhen publike ose që nuk janë konfidenciale në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Përfaqësuesi i Ofertuesit

Nënshkrimi

Vula

Shtojca 5.

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor]

FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE

Operatori ekonomik privat që do të kontraktohet, duhet të ofrojë një shërbim i cili duhet të përfshijë:

- Marrjen në dorëzim të materjalit të papastër të sjellë nga përgjegjëset e materjalit (të cilat janë në organikën e spitalit) sipas orarit të përcaktuar, rregullave dhe protokolleve të higjenes dhe manualeve të kujdesit spitalor.
- Gjithçka që çohet për tu larë, dokumentohet me shkrim si nga përgjegjëset e materjalit ashtu edhe nga punonjësi/sja e lavanterisë që merret me pranimin dhe dorëzimin e materjalit;
- Larjen e materjalit të butë;
- Hekurosjen dhe paketimin e materjalit të butë;
- Dorëzimin e materjalit të larë përgjegjëseve të materjalit me dokumentacion të plotë, të sigluar nga të dy palët.
- Ripertëritjen e materjalit të butë në baze të normativave dhe kërkesave të AK.
- Shërbimi do të ofrohet gjatë gjithë javës, prej ditës së hënë deri ditën e dielë.
- Operatori ekonomik do të realizojë furnizimin me materjale të buta, veshje pacienti dhe veshje personeli, në bazë të kërkesave të institucionit duke u bazuar në pëvojat e mëparshme, numurit të shtretërve, shfrytezimit të shtratit, si dhe në normativat përkatëse të përdorimit të materjaleve të buta dhe veshjeve 1 herë në vit, dhe për më shumë vjet për disa materjale me cikël të gjatë zëvendësimi.

Materiali i butë që do të lahet nga operatori ekonomik privat, grupohet në 3 (tre) kategori:

1. Material i butë i pacientëve
2. Material i butë në sallat e operacionit
3. Material i butë i personelit

Materia

1. Material i butë për pacientët:

- Çarçafë shtrati (i poshtëm; i sipërm)
- Mbulesa dysheku gome
- Këllëf jastëku
- Jastëk krevati
- Batanije
- Peshqira
- Pizhama pacienti (burrash, grash, fëmijësh)
- Fustane grash
- Piceta fanellati gash
- Piceta fanellati pediatrike
- Këllëf dysheku

- Çarçafë fëmijësh
- Batanije fëmijësh
- Pandofla pacienti
- Perde

2. Materiali i butë për sallat e operacionit:

- Kompresa
- Tampona
- Kostume kirurgu
- Bluza personeli
- Peshqirë salle
- Piceta salle
- Pandofla sale

3. Materiali i butë për stafin mjekësor:

- Përparëse për mjekë / personel ndihmës
- Kostum personeli për infermier / sanitar / personel ndihmës
- Peshqirë për mjekë / infermier / personel ndihmës
- Çarçafë , faqe jastëku, jastëkë, batanije të mjekëve roje
- Pandofla

Ndërimi i shtratit të pacientit do të bëhet për çdo dalje nga spitali, ku do të lahen të gjitha materialet e shtratit, këllëf dysheku, çarçafë, faqe jastëku, jastek, batanije, peshqir, pizhame, ndërsa për pacientet problematikë etj, ndërimi do të bëhet çdo tre ditë dhe për pacientët e shërbimeve të kirurgjisë, reanimacionit, pediatriisë, maternitetit, infektivit çdo ditë në çdo moment që kërkohet nga k/infermieri i pavionit, kur ndërimi i shtratit bëhet i domosdoshëm për higjenën e pacientit.

Në tabelën e mëposhtme jepet më e detajuar shpeshësia e ndërrimit të shtratit.

Nr	Shërbimi	Shpeshësia e ndërrimit të shtratit
1	Kirurgji	1 x ditë të operuarit & sipas nevojës 1 x 3 ditë para operacionit
2	Reanimacion	1 x ditë & sipas nevojës
3	Pediatri	1 x ditë & sipas nevojës
4	Infektiv	1 x 3 ditë & sipas nevojës
5	Dermatologji	1 x ditë & sipas nevojës
6	Neurologji	1 x 3 ditë & sipas nevojës
7	Patologji	1 x 3 ditë & sipas nevojës
8	Kardiologji	1 x 3 ditë & sipas nevojës
9	Urgjenca Spitalore	1 x ditë & sipas nevojës
10	Paliativi	1 x ditë & sipas nevojës
11	Obsetrikë	1 x ditë & sipas nevojës
12	Gjinekologji	1 x ditë të operuarit & sipas nevojës 1 x 3 ditë para operacionit
13	Poliklinikë	1 x javë & sipas nevojës

Përsa i përket veshjeve të personelit do të lahen kompletet e mjekëve dhe infermierëve dy herë në javë, veshjet e shtratit të mjekëve roje çdo ditë, si dhe kostumet e stafit të sallave dhe galloshet pas çdo operacioni, po kështu edhe peshqirat e personelit do të lahen çdo ditë.

Po ashtu kemi edhe shërbimin e poliklinikës që nuk është pasqyruar në tabelle por që ka për të larë 1 herë në javë (ose dhe dy herë kur është e nevojshme) çarçafët e shtretërve të vizitave, peshqirët, faqe jasteku dhe veshje personeli.

Nevojat për inventar për materialin e butë për shërbimet me shtretër

Nisur nga numri i shtretërve që duhen kompletuar sipas përlogaritjes së shfrytëzimit të shtratit (e paraqitur në tabelën nr.1), në bazë të koeficientit të ndërrimit të shtratit si dhe nevojat për inventar nga shërbimet, dhe në mbështetje të VKM nr. 416 datë 15.12.1976, si edhe udhëzimin të përbashkët të Ministrisë së Financave dhe të Ministrisë të Shëndetësisë datë 21.05.1986 “Për normativat dhe afatet e përdorimit të paisjeve dhe normat e zëvendësimit të veshbathjeve të punonjësve”, si dhe eksperiencës sonë, operatori ekonomik duhet të bëjë furnizimin e materialit të butë, i cili do të sillet në magazinën e spitalit në prani të komisionit si me poshte:

Nr	Emërtimi	Njësi	Materjal për tu sjellë
1	Çarçaf i poshtëm 100% pambuk 260x160	copë	510
2	Çarçaf i sipërm 100% pambuk 260x160	copë	480
3	Çarçaf pediatrik 200x140	copë	90
4	Këllëf jasteku 100% pambuk 80x50	copë	500
5	Peshqir duarsh 100% pambuk 90x50	copë	550
6	Kllëf dysheku i gomuar 210x100 me llastik	copë	445
7	Dyshekë 200x90	copë	150
8	Dyshekë për pediatriinë 140x70x20	copë	10
9	Pandofla plastike	palë	110
10	Pizhame femije	palë	30
11	Pizhame burri trikotazh	palë	100
12	Bizhame grash trikotazh	palë	80
13	Fustane grash trikotazh	copë	50
14	Piceta fanellati 20ale20tric 80x80	copë	500
15	Piceta fanellati grash 80x50	copë	800
16	Jastekë 80x40 me mbushje sintetike	copë	445
17	Piceta 20salle operacioni 100x100	copë	100
18	Batanije 220x160 60% lesh 40% akrelik	copë	460
19	Batanije pediatrike 150x100	copë	36
20	Komplete operacioni të sallës (jeshile) 100% pambuk	copë	108
21	Infermier pavioni (uniform bojëqielli)	palë	118
22	Infermirë + Mjek Urgjence + salla (Uniformë blu)	palë	82
23	Inferierë +Mjek reanimacioni (Uniformë Jeshile)	palë	80
24	Infermierë pediatri (Uniformë me kukulla + panallon bojëqelli)	palë	19
25	Infermierë pediatri (Uniformë me kukulla + panallon blu)	palë	19
26	Teknik laborator (Bluzë bardhë + Pantallona blu)	palë	2

27	Teknik imazheri (Uniformë Gri)	palë	13
28	Komplete sanitari (vishnjë)	copë	73
29	Komplete personel hotelerie (bardhe)	copë	23
30	Komplete infermjeri maternitet	copë	35
31	Bluza mjeku	copë	142

Nevojat për inventar për materialin e butë për sallat operative

Nr	Emërtimi	Njësia	Nr i ekipit të sallës	Frekuenca e zëvendësimit	Sasia totale në vit
1	Kostumet e ekipit të sallës spital	copë	23	2 copë / 1 vit	46
2	Kostumet e ekipit të sallës maternitet	copë	24	2 copë / 1 vit	48
1	Kostumet e ekipit të sallës ORL - Okulistikë	copë	7	2 copë / 1 vit	14
2	Peshqirë salle	copë	54	2 copë / 1 vit	108

Nevojat për inventar për materialin e butë për personelin mjekësor (mjek, kr/infermier, infermier, fizioterapist, sanitare etj), operatori ekonomik duhet të plotësojë nevojat për inventar të materialit të butë të personelit mjekësor si më poshtë:

Nr	Emërtimi	Inventari në përdorim	Frekuenca e zëvendësimit	Sasia totale në vit
1	Përparse mjeku	142	1	142
2	Kostume infermieri dhe mjeku	353	1	353
3	Kostume laboranti	15	1	15
4	Kostume personel ndihmës	23	1	23
3	Kostume sanitare	73	1	73
4	Peshqirë personeli	315	1	315

Cilësojmë që i gjithë materiali që do të ripërtërihet duhet të ketë logon dhe emërtimin e Spitalit Rajonal Korçë, detyrimisht të stampuar me material jo të dëmshëm për pacientin. I

gjithë materiali që do të ripërtërihet, kalon në inventar të spitalit, pas përfundimit të kontratës.

Gjithashtu, edhe materiali i butë i personelit shëndetësor duhet të ketë të stampuar në xhep logon dhe emërtimin e spitalit, dhe do të jetë me ngjyra të ndryshme sipas pavioneve (e përcaktuar nga ministria).

Materiali i butë që do të blihet, do të lahet dhe zëvendësohet sipas jetëgjatësisë së materialit (përbërjes së tij) dhe kushteve të autoritetit kontraktor, do të jetë:

- Dyshek spitalor, - këllëf dysheku; - jastëk; - këllëf jastëku; - çarçaf shtrati; - Pizhame pacienti, - këmisha grash (robdishan grash); - pandofla pacienti dhe personeli; - çarçaf neonati; - batanije; - batanije neonati; - kompresa; - kostume të ekipit të sallës; - peshqir personeli / pacienti / salle; - përparëse mjeku; - kostume infermieri / sanitare. Dyshekët do të zëvendësohen jo të gjithë shtretërit, por ato që janë llogaritur në bazë të shfrytëzimit të shtratit, pasi ndërimi i tyre është bërë në vitet 2021 dhe një pjese do të bëhet gjatë fillimviti në 2022.

Dyshekët që do të dalin nga përdorimi pas plotësimit të afatit do të terhiqen përsëri nga OE kundrejt proces verbaleve të regullta për tu asgjësuar.

Përveç larjes operatori ekonomik i kontraktuar duhet të ripërtërije materialin e butë ekzistues sipas tabelës së mëposhtme:

Tabelë me materiale të buta dhe veshje që do sillen për rinovimin e inventarit ekzistues

Nr	Emërtimi	Njësia	Sasia e inventarit që duhet për funksionimin e spitalit	Sasia e që duhet të silllet vitin 1	Sasia që duhet të silllet vitin 2	Sasia që duhet të silllet vitin 3	Sasia që duhet të silllet vitin 4	Jetëgjatësia
1	Çarçaf i poshtëm	cope	510	510	510	510	510	1vit
2	Çarçaf i sipërm	cope	480	480	480	480	480	1vit
3	Çarçaf pediatrik	cope	90	90	90	90	90	1vit
4	Këllëf jasteku	cope	500	500	500	500	500	1vit
5	Peshqir duarsh	cope	550	550	550	550	550	1vit
6	Këllëf dysheku i gomuar me llastik	cope	445	445	445	445	445	1vit
7	Dyshekë 200x90	cope	120				120	4vjet
8	Dyshekë për pediatriinë	cope	8				8	4vjet

9	Pandofla plastike	pale	110	110	110	110	110	1vit
10	Pizhame fëmije	pale	30	30	30	30	30	1vit
11	Pizhame burri trikotazh	pale	100	100	100	100	100	1vit
12	Bizhame grash trikotazh	pale	80	80	80	80	80	1vit
13	Fustane grash trikotazh	cope	50	50	50	50	50	1vit
14	Piceta fanellati pediatrik 80x80	cope	500	500	500	500	500	1vit
15	Piceta fanellati grash 80x50	cope	800	800	800	800	800	1vit
16	Jastëkë	cope	356		220		136	4vjet
17	Piceta salle operacioni	cope	100	100	100	100	100	1vit
18	Batanije 220x160	cope	368		260		108	4vjet
19	Batanije pediatrike 150x100	cope	32			32		4vjet
20	Komplete operacioni të sallës	cope	108	108	108	108	108	1vit
21	Infermier pavioni (uniformë bojëqielli)	cope	118	118	118	118	118	1vit
22	Infermier + Mjek Urgjence + salla (Uniformë blu)	cope	82	82	82	82	82	1vit
23	Infermierë + Mjek reanimacioni (Uniformë Jeshile)	cope	80	80	80	80	80	1vit
24	Infermier pediatri (Uniformë me kukulla + panallon bojëqell)	cope	19	19	19	19	19	1vit

25	Infermier pediatri (Uniformë me kukulla + panallon blu)	cope	19	19	19	19	19	1vit
26	Teknik laborator (Bluzë bardhë + Pantallona blu)	cope	2	2	2	2	2	1vit
27	Teknik imazheri (Uniforma Gri)	cope	13	13	13	13	13	1vit
28	Komplete sanitari (vishnjë)	cope	73	73	73	73	73	1vit
29	Komplet personeli hotelerie (bardhë)	cope	23	23	23	23	23	1vit
30	Komplete infermjeri maternitet	cope	35	35	35	35	35	1vit
31	Bluza mjeku	cope	142	142	142	142	142	1vit

Materialet do të sillen sipas kërkesës sonë dhe duke parë situatën konkrete, por kjo talelë krijon një farë parashikimi.

SPECIFIKIMET TEKNIKE

Më poshtë janë specifikimet e materialit të butë dhe veshjeve të personelit.

Specifikimet teknike të materialit të butë për pacientin

Emërtimi	Njësia	Specifikimet Teknike	Dimensionet	Lloji i materialit
Dyshek tek spitalor	Copë	Dysheku të plotesoje kërkesat për tu përdorur në spitale, përbërja nga brënda me dy shtresa sfungjeri të fortë, ku nga njëra anë të ketë porozitet për qarkullimin e ajrit, dhe i veshur nga jashtë me mbulesë të fortë të padepërtueshme nga lengjet biologjike. Dysheget e reanimacionit duhet të jenë me ndarje të	200x90x15	

		pershtatshem sipas krevatit me te gjitha specifikimet e mesiperme.		
Dyshek pediatrik	Copë	Dysheku të jetë i njëtrajtshëm (pa ndarje), përbërja nga brënda me dy shtresa sfungjeri të fortë, ku nga njëra anë të ketë porozitet për qarkullimin e ajrit, dhe i veshur nga jashtë me mbulesë të fortë të padepërtueshme, injifugo (kundër zjarrit), antibakteriale dhe antialergjike.	140x70x20	
Jastëk	Copë	Mbushje uniforme me fibra sintetike, ngjyrë e bardhë,.te kete te shenuar datën e futjes në materialit të butë në përdorim në shërbimin mjekësor.	50x80 cm	Fibra Sintetike
Këllëf dysheku	Copë	Material nga njera ane pambuk dhe nga ana tjetër e papershkueshme nga uji me qepje me llastik per te futur dyshekun , te kete te shenuar . Logo SK. me emërtesën sipas kërkesës së autoritetit kontraktor,	200x90x20	100 % pambuk + material I papershkueshem nga uji
Këllëf dysheku pediatrik	Copë			
Çarçafe shtrati	Copë	160-180gr/m ² , Me qepje nga të katërta anët. Ngjyrë sipas kerkeses se autoritetit kontraktor. Te jete shenuar Logoja e Spitalit të me emërtesën me ngjyrë sipas kërkesës së autoritetit kontraktor,	260x160 cm	75% pambuk 25% poliester
Çarçafe shtrati pediatrik	Copë	160-180gr/m ² , Me qepje nga të katërta anët. Ngjyrë sipas kerkeses se autoritetit kontraktor. Logoja e Spitalit me emërtesën me ngjyrë sipas kërkesës së autoritetit kontraktor	200x140 cm	75 % pambuk 25% poliester

Piceta grash	Copë	Te jete fanellate ,materjal I plote ,me dezenjo dhe ngjyre sipas kerkeses se AK	80x50cm	100% pambuk
Kellef jasteku	Copë	Mbulese dyshe,ku nga njera ane ka nje te care si xhep,per te lejuar futjen e jastekut Ngjyre e bardhe 160-180 gr/m ² me logon e SK .	50x80 cm	100% pambuk
Peshqire pacienti	Copë	Material pambuku, ngjyre e bardhe me logon e Spitalit.	90x50	100% pambuk,
Pizhama Pacienti (burra/grash)	Copë	Pizhama komplet (bluze +pantallona) , material i plote njëngjyrëshe ose me dezenjo pesha 350 gr/m ² , pantallonat me llastik xhaketa me jake kemishe ose jake V, me mëngë të gjata të gjëra, masat (XS, S,M, L, XL, XXL) me kopsa perpara ose pa kopsa . Specifikat e me siperme - sipas kërkesës së autoritetit kontraktor. Me logon e Spitalit te SK.	Gjatësia sipas kërkesës së autoritetit kontraktor.	Materiali i 75% pambuk dhe 25 % polyester.lahet ne temperature 60°
Kemisha grash	Copë			
Piceta pediatrike	Copë	Te jete fanellate ,materjal I plote ,me dezenjo dhe ngjyre sipas kerkeses se AK	80x80cm	100% pambuk
Kompresa kirurgjie	Copë	Te jete material pambuk e qepur metegel ne te 4 anet ,peshe 180-220 gr/m ² , me vrime ne mes ngjyre sipas kerkeses se autoritetit kontraktor me material të butë në përdorim në shërbimin mjekësor	100x100cm	100% pambuk,

Pandofla Pacienti	palë	Pandofla për përdorim spitalor, material plastik, me gome poroze me ngjyra te ndryshme. Materiali të jetë antirreshkitës, rezistentë ndaj gërryerjes dhe vajit, si dhe i padepërtueshëm nga uji. Ngjyra sipas kërkesës së autoritetit kontraktor.	Numrat e pandoflave sipas kërkesës së autoritetit kontraktor.	.
Batanije	Copë	Te jete 60% lesh dhe 40 % akrilik. Ngjyra sipas kerkeses se autoritetit kontraktor. Te kete te shenuar Logon e SK.	220x160	Te jete 60% lesh dhe 40 % akrilik,
Batanije pediatrike	Copë	Te jete 60% lesh dhe 40 % akrilik Ngjyra sipas kerkeses se autoritetit kontraktor.	150x110	Te jete 60% lesh dhe 40 % akrilik, me permasa

Specifikimet teknike të materialit të butë të ekipit të sallave operatore

Emërtimi	Njësia	Specifikimet Teknike	Dimensionet	Lloji i materialit
Kostume ekipi salle jo sterile (Bluzë dhe Pantallona)	Copë	<p>Bluzë dhe Pantallona:</p> <p>Bluzë me jakë në formë V me mëngë të shkurtra të gjëra, me xhep lart majtas ku në palën e xhepit të shenohet logo SK.</p> <p>Pantallona unisex, me llastikë në pjesën e belit, me ose pa xhepa në pjesën e përparme. Masat (S, M, L, XL) sipas kërkesës së autoritetit kontraktor.</p> <p>Densiteti i thurjes 160- 180 gr.</p> <p>Ngjyrë jeshile e errët</p>	Gjatësia e bluzës dhe gjerësia sipas kërkesës se autoritetit kontraktor; Gjatësia pantallonit sipas kërkesës së autoritetit kontraktor.	Përbërje 100% pambuk,
Peshqir salle		Material pambuku, ngjyre e bardhe me logon e SK.	90x50	100% pambuk,

Specifikimet teknike të materialit të butë për personelin mjeksor

Emërtimi	Njësia	Specifikimet Teknike	Dimensionet	Lloji I materialit
----------	--------	----------------------	-------------	--------------------

<p>Përparëse Mjeku (Mashkull dhe Femër) unisex</p>	<p>copë</p>	<p>Material Pambuku, ngjyrë e bardhë, ku në të majtë ka një xhep të vogël të drejtë ku do të vendoset logoja e Spitalit . Densitetin e thurjes 230 gr/m². Jaka e përparësës të jetë e prerë drejtë (jakë ruse), gjatësia sipas kërkesës së autoritetit kontraktor, me mëngë të gjata , dhe përpara të jetë me perçina ose kopsa, si dhe me dy xhepa anash të futur.</p>	<p>Gjatësia e përparësës dhe masat (S,M,L,XL,XXL), sipas kërkesës së autoritetit.</p>	<p>100% pambuk,</p>
<p>Kostume Infermieri (Bluzë me Pantallona) unisex</p>	<p>copë</p>	<p>Bluza me jakë V të trashë me xhep të vogël lart majtas, ku të shënohet pozicioni dhe logoja e Spitalit. Me mëngë të shkurtra të gjëra dhe me dy xhepa anësorë poshtë bluzës. Pantallona unisex, me llastikë në pjesën e belit, me ose pa xhepa në pjesën e përparme sipas kërkesës së autoritetit kontraktor. Ngjyrat sipas kerkeses se AK Densiteti i thurjes 160- 180 gr /m²</p>	<p>Masat (S,M,L,XL,XXL) sipas kërkesës së autoritetit kontraktor. Gjatësia e bluzës dhe gjerësia sipas AK.. Gjatësia pantallonit sipas kërkesës së autoritetit kontraktor.</p>	<p>Materiali 65% pambuk dhe 35 % poliestër, lahet në temperaturë 60°.</p>
<p>Kostume sanitare (Bluzë me Pantallona)</p>		<p>Bluza me jakë V të trashë me xhep të vogël lart majtas, ku të shënohet pozicioni dhe logoja e Spitalit Me mëngë të shkurtra të gjëra dhe me dy xhepa anësorë poshtë bluzës. Pantallona unisex, me llastikë në pjesën e belit, me ose pa xhepa në pjesën e përparme sipas kërkesës së autoritetit kontraktor. Ngjyra vishnje Densiteti i thurjes 160- 180 gr /m²</p>	<p>Masat (S,M,L,XL,XXL) sipas kërkesës së autoritetit kontraktor. Gjatësia e bluzës dhe gjerësia sipas AK.. Gjatësia pantallonit sipas kërkesës së autoritetit</p>	<p>Materiali 65% pambuk dhe 35 % poliestër, lahet në temperaturë 60°.</p>

			kontraktor.	
Peshqire personeli	cope	Material pambuku, ngjyre e bardhe me logon e SRV-se si si dhe datën e futjes në materialit të butë në përdorim në shërbimin mjekësor.	90x50	100% pambuk,
Kostume personeli ndihmes (Bluzë me Pantallona) unisex	copë	Bluza me jakë V të trashë me xhep të vogël lart majtas, ku të shënohet pozicioni dhe logoja e Spitalit. Me mëngë të shkurtra të gjëra dhe me dy xhepa anësorë poshtë bluzës. Pantallona unisex , me llastikë në pjesën e belit, me ose pa xhepa në pjesën e përparme sipas kërkesës së autoritetit kontraktor. Ngjyrat e bardhe Densiteti i thurjes 160- 180 gr /m ²	Masat (S,M,L,XL,XXL) sipas kërkesës së autoritetit kontraktor. Gjatësia e bluzës dhe gjerësia sipas AK.. Gjatësia pantallonit sipas kërkesës së autoritetit kontraktor.	Materiali 65% pambuk dhe 35 % poliester, lahet në temperaturë 60°.

Specifikimet teknike të Menaxhimit të Procesit të Lavanderisë

- Shërbimin e Lavanterisë operatori ekonomik kontraktues, do ta kryejë në ambjentet e lavanterisë egzistuese të Spitalit Korçë, kundrejt pagesës së qerasë mujore në bazë të VKM nr. 54 datë 05.02.2014.
- Operatori ekonomik ofertues duhet të disponojë makineri për larje profesionale gjithësej 2 (dy) copë, (njëra e dedikuar për larjen e teshave të shërbimit infektiv), 2 (dy) makineri tharje profesionale, 1 (një) makineri profesionale hekurosje, (1 një) makineri paketimi, 1 (një) peshore elektronike me kapacitet jo më pak se 100 kg, karroca metalike shumëkatëse transporti për materialin e butë gjithësej 10 (dhjetë) copë, të cilat duhet të garantojnë një kapacitet larjeje rreth 234 kg /ditë, dhe që duhet ti instalojë në ambjentet e lavanterisë.

Nr	Emërtimi	Njësia	Sasia minimale e kerkuar
1	Makineri larese profesionale per nje kapacitet lares minimalisht prej 40 kg/dite (Duhet te jene prodhime te dhjetevjecarit te fundit).	copë	2 (dy)
2	Makine Hekurosese (Rul) Profesionale (mbi dy metra gjatesi)	copë	1 (nje)
3	Makineri Paketimi Profesionale për paketim rrobash, per nje kapacitet paketimi minimalisht prej 40 kg/dite (Duhet te jene prodhime te dhjetevjecarit te fundit).	cope	1 (një)

4	Karroca metalike shumekateshe per materialin e bute	Cope	10
5	Peshore elektronike mbi 100 kg e cila duhet të jetë e kalibruar dhe të shoqëruar me akt kolaudimi nga autoritete përkatëse (Drejtoria e përgjithshme e Metrologjisë)	Cope	1

- Operatoti ekonomik ofertues duhet ti disponojë makineritë e sipërcituara dhe t'i vërtetojë ato me dokumenta (fatura blerje dhe/ose zhdoganimi dhe/ose kontratë qeraje për çdo makineri). Për makineritë e marra me qera duhet të paraqesë dokumenta që vërtetojnë pronësinë e tyre nga qeradhënësi (fatura blerje dhe/ose zhdoganimi) si dhe të deklarohen që makineritë nuk janë të angazhuara në ndonjë kontratë tjetër sipërmarrjeje. Makineritë larëse duhet të jenë detyrimisht prodhime të dhjetëvjeçarit të fundit.
- Operatori ekonomik do të ofrojë shërbimin e tij, nga procesi i pranimit te materjalit te ndotur në lavanteri, numurimin, regjistrimin në librin e lavanterisë, ndarjen e materjalit sipas ngjyrave, llojit, shkallës së ndotjes, larjen, tharjen, hekurosjen, paketimin deri te dorëzimi i materjalit të larë, për çdo pavion tek pergjegjësja e materjalit (e cila është punonjese e spitalit Korçë), duke firmosur në bllokun e dorëzimit të teshave dhe duke mbajtur kopjen e dytë të bllokut ku ka firmosur edhe pergjegjësja e materjalit.
- Operatori ekonomik kontraktues, menjëhere pas lidhjes së kontratës dhe para fillimit të shërbimit duhet të lidhë kontrata me KESH dhe UIK për furnizimin me energji elektrike dhe ujë.
- Operatori ekonomik kontraktues do të pranojë çdo ditë teshat e dorëzuara për larje nga pergjegjësjet e materjalit, kundrejt dokumentacionit përkatës, ku do të firmosin pergjegjësi i materjalit dhe përfaqesuesi i subjektit kontraktues.
- Sipërmarrësi do të lajë, dezinfektojë, thajë, paketojë dhe do te dorëzojë materialin te pergjegjësja e materjalit çdo ditë të javës me dy turne, me perjashtim të ditës së dielë që mund të punojë me nje turn.
- Larja dhe dezinfektimi, në repartin e lavanderisë do të bëhet në mënyrë të përqëndruar, duke respektuar të gjitha procedurat dhe protokollet e higjienës, nga marrja në dorëzim e materialit të butë të papastër të ndarë sipas nëndarjeve dhe zonave të rrezikshmërisë, tek dorëzimi i materialit të butë, të larë, të hekurosur dhe të paketuuar sipas këtyre protokolleve, duke respektuar te gjitha rregullat për parandalimin e infeksioneve nozokomiale.
- Operatori ekonomik do të dorëzojë rrobat e lara, thara, të hekurosura dhe të paketuara, tek pergjegjesi materjal, çdo ditë të javës dhe shpesh edhe dy herë në ditë në varësi të nevojave.
- Pergjegjësi materjal duket të furnizohet me qese nga OE, për të grumbulluar teshat e palara, për të shmangur infeksionet dhe kontaminimin. Teshat e pavionit infektiv duhet të kenë një ambalazh të ndryshëm në ngjyrë me pavionet e tjera dhe larja e tyre të bëhet më vete.
- Solucionet larëse dhe dezindektuese të teshave duhet të plotësojnë të gjitha parametrat për larje me makineri dhe sipas nevojës të përdoren edhe dizinfektantë të ndryshëm.

-
- OE mban përgjegjësi për dëmtimin e materjalit gjatë larjes dhe bën riparimin apo zëvendësimin e tyre kur është e nevojshme.
 - Në rastet kur makineritë larëse apo tharëse janë me defekt, ndonjë avari elektrike, apo ndonjë ngjarje e paparashikuar, OE merr përsipër riparimin dhe mirëmbajtjen e tyre në mënyrë që të mos pengohet procesi i punës.
 - Operatori ekonomik do të bëjë edhe plotësimin e nevojave të spitalit me materjale të buta shtrati, veshje pacienti, veshje personeli, duke e dorëzuar materjalin me logon e spitalit (sipas specifikimeve teknike të përcaktuara) në magazinën e spitalit, në prani të një komisioni dhe pasi bëhet hyrje në magazinën e spitalit, më tej ky materjal do të shpërndahet pavioneve sipas nevojave dhe kërkesave nga zyra e hotelierisë dhe do të menaxhohet nga përgjegjëset e materjalit të çdo pavioni deri në momentin e daljes nga përdorimi kur përmbush afatin e përdorimit.
 - Çdo furnizim me materjale të buta do të merret në dorëzim nga një komision i ngritur nga drejtoria, icili jo vetëm do të kontrollojë përmbushjen e specifikimeve teknike, por dhe do të peshoje çdo materjal për të përcaktuar peshën specifike, që shërben për të përlllogaritur sasinë e teshave që çohen për tu lare. (Kjo bëhet para magazinimit).
 - Ambjenti i pranimit të teshave të ndotura duhet të jetë i ndarë nga ambienti i tërheqjes së materjalit të larë, si dhe tharrja e teshave duhet të bëhet në ambjentet e lavanterisë.
 - Autoriteti kontraktor ka të drejtë të ushtrojë kontroll në prani të përfaqesuesit të OE, për mënyrën e pranimit, larjes, dorëzimit të teshave si dhe mënyrën e mbajtjes së dokumentacionit në regjistrin e lavanterisë si dhe ripërtëritjen e materjalit të butë.
 - Ndërrimi i shtratit të pacientit do të bëhet për çdo dalje nga spitali, ku do të lahen të gjitha materjalet e shtratit, jastëku, batanija, veshje pacienti, ndërsa për pacientet jo problematikë ndërrimi do të bëhet çdo tre ditë dhe për pacientët e kirurgjisë, reanimacionit, dermatologjisë, maternitetit, urgjencës etj, çdo ditë në çdo moment që kërkohet nga k/infermjerja e pavionit, kur ndërrimi i shtratit bëhet i domosdoshëm për higjienën e pacientit. Për raste të gjendjes së jashtëzakonshme, epidemive apo pandemive, lavanderia do të funksionojë sipas kushteve që do të vendosë Drejtoria e Spitalit.

Etapat e këtij procesi çdo ditë:

- Çdo ditë përgjegjësja e materjalit të çdo pavioni ose personi i autorizuar nga k/infermjeri, çon në lavanteri teshat e palara, të shënuara me copë në bllokun e teshave dhe i dorëzon keto në prezencë të përfaqesuesit të operatorit ekonomik, i cili pasi i merr në dorëzim i regjistron në librin e lavanterisë.
- Ky dorëzim do të bëhet çdo ditë në ambjentet e lavanterisë, në vendin e caktuar, prej orës 7⁰⁰ – 9⁰⁰ dhe prej orës 12⁰⁰ – 14⁰⁰ dhe për urgjencën, sallën e operacionit sa herë të jetë e nevojshme.
- Tërheqja e materjalit të larë do të kryhet përsëri në ambjentin e lavanterisë, në bazë të dokumentit (blloku i dorëzimit të teshave). Pasi numërohet materjali i lare dhe rakordon me sasinë e bllokut atëherë firmosin të dy palët në bllok dhe në lavanteri qëndron kopja e dytë, origjinali mbetet në bllok.
- Blloku i dorëzimit të teshave është i siglur dhe tërhiqet nga përgjegjëset e materjalit në zyrën e hotelierisë.

-
- Ne fillim të çdo jave përgjegjesja e materjalit dorëzon në zyrën e hotelerisë bllokun e teshave, për të bërë përlogaritjen e sasisë së teshave të lara, duke u bazuar në peshat specifike të përcaktuara nga komisioni i pranimit të materjaleve, ku dhe hartohet një përmbledhëse javore për sasinë e teshave të lara në kg për çdo pavion çdo ditë. Kjo pasqyrë firmoset nga përgjegjesja e materjalit dhe k/infermjerja e pavionit.
 - Në fund të muajit, zyra e hotelerisë, bazuar në pasqyrat javore, harton përbledhësen mujore të sigluar nga Përgjegjësja e Sektorit të Hotelerisë, Përgjegjësja e Sektorit të Financës dhe nga Zv/Drejtori i Shërbimeve Administrative, e cila pasi kuadrohet me operatorin ekonomik shërben si dokument për likuidimin e këtij shërbimi.

Shtojca 6

(Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor)

(Kjo Shtojcë në rastin e Marrëveshjes Kuadër do të plotësohet nga autoriteti/enti kontraktor vetëm gjatë rihapjes së procesit të mini-konkursit)

FORMULARI I SHËRBIMEVE DHE GRAFIKUT TË EKZEKUTIMIT

Shërbimi që kërkohet:

<i>1</i>	<i>2</i>	<i>3</i>	<i>4</i>	<i>6</i>	
Artikulli	Përshkrimi i shërbimit	Sasia per 48 Muaj	çmimi për njësi	Çmimi total për shërbim	Afati
1.	Shërbimi i lavanderisë dhe hotelerisë për Drejtorinë e Shërbimit Spitalor, Korçë	341,364			48 (dyzetë e tetë) Muaj.

Afatet e ekzekutimit: 48 (dyzetë e tetë) Muaj, nga data e lidhjes së Kontratës.

Shtojca 7

(Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor)

FORMULARI I TERMAVE TË REFERENCËS

Objekti dhe qëllimi i shërbimeve: Kryerja e Shërbimit të Lavanderise për Drejtorinë e Shërbimit Spitalor, Korçë.

Detyrat: Shërbimi i lavanderise sipas Specifikimeve Teknike.

Shpërndarja: Brenda Drejtorise së Shërbimit Spitalor, Korçë.

Vendi i kryerjes së shërbimeve: Në ambientet e Shërbimit Spitalor, Korçë.

Shtojca 8

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor]

FORMULAR I I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT

1. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PËRZGJEDHJES/ KUALIFIKIMIT

Ofertuesi deklaron se:

- a) është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;
- b) nuk është në proces falimentimi (status aktiv);
- c) nuk është dënuar për ndonjë vepër penale, në përputhje me nenin 76/1 të LPP-së;
- ç) personi (personat) që veprojnë si anëtar i organit administrativ, drejtori ose mbikëqyrësi, aksioneri ose ortak, ose që ka fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda Operatorit Ekonomik, nuk është i dënuar ose nuk ka qenë i dënuar nga një vendimi i gjykatës i formës së prerë për çdo vepër penale, të përcaktuar në nenin 76/1 të LPP-së;
- d) nuk është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë në lidhje me veprimtarinë profesionale;
- dh) nuk ka pagesa të pashlyera të taksave dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore, ose ndodhet në një prej kushteve të parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së;
- e) ka paguar energjinë elektrike dhe plotëson kërkesat që burojnë nga legjislacioni në fuqi. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.
- f) nuk është në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;
- g) ushtron veprimtarinë në përputhje me legjislacionin përkatës mjedisor, social dhe të punës;
- gj) ka paraqitur një Ofertë të pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;
- h) kryen aktivitetin në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi.
- i) nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë/kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të përfituar fonde publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.

Nëse gjuha e përdorur në procedurë është gjuha shqipe, atëherë dokumentet e gjuhës së huaj duhet të shoqërohen nga një përkthim i noterizuar në shqip.

Këto kritere duhet të përmbushen me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas Shtojcës 9.

Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, secili anëtar i grupit duhet të paraqesë Vetëdeklarimin e lartpërmendur.

Në rast se operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, Vetëdeklarimi i lartpërmendur duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.

Kriteret e Përgjithshme të Pranimit nuk duhet të ndryshohen nga Autoritetet/Entet Kontraktore.

Në çdo rast, Autoriteti/EntiKontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga Operatori Ekonomik, për sa më sipër.

- Nëse oferta paraqitet nga një bashkim Operatorësh Ekonomikë, do të paraqitet :

Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Operatorëve Ekonomikë, ku caktohet përfaqësuesi, përqindja e pjesëmarrjes në bashkim, dhe elementët që merr përsipër të realizojë secili prej anëtarëve të bashkimit.

- Nëse, një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai i vërteton autoritetit ose entit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme, duke dorëzuar një angazhim me shkrim të këtyre subjekteve për këtë qëllim.

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

2. **Ofertuesi duhet të paraqesë:**

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

1. Operatori ekonomik ofertues, duhet të jetë i pajisur me leje mjedisore të Tipit B “Pastrim kimik”, lëshuar nga Qendra Kombëtare e Biznesit (QKB), për vendin ku ushtron këtë aktivitet, në fushën e objektit të prokurimit.
2. Operatori ekonomik duhet të paraqesë certifikatë që vërteton sistemin e kontrollit të Biokontaminimit **SSH EN 14065:2016 / UNI ENI 14065** (e vlefshme) ose ekuivalente.

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

1. Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare (2019, 2020, 2021), ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë **jo më e vogël se 40% e vlerës së fondit limit**. Kriteri konsiderohet i përmbushuar nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, pra 40% e vlerës së fondit limit, në të paktën 1 (një) vit të periudhës së kërkuar të viteve financiare.
2. Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin kopje të certifikuara të bilanceve të viteve: (2019, 2020, 2021) të paraqitura pranë autoriteteve përkatëse tatimore. Në rast se operatori ekonomik është në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, të ligjit nr.10091, datë 05.03.2009, atëherë bilancet duhet të shoqërohen edhe me raportet e auditimit ligjor të pasqyrave financiare vjetore, të kryera, nga auditues ligjorë ose shoqëri audituese. Kriteri konsiderohet i përmbushuar nëse në dy bilance të njëpasnjëshme nuk ka raport negative ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

2.3 Kapaciteti teknik:

1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme të kryera gjatë 3 (tre) viteve të fundit **nga data e publikimit të njoftimit të kontratës**, në vlerën

jo më pak se 40% e vlerës së fondit limit. Këto furnizime të mëparshme, të ngjashme, duhet të vërtetohen me dokumentacionin si më poshtë:

- a) Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me ente publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetimin e lëshuar nga enti publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ose faturat tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.
- b) Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me subjekte private, operatori ekonomik duhet të paraqesë faturën përkatëse tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

2. Operatori ekonomik pjesëmarrës, duhet të ketë në pronësi ose në përdorim të paktën 1 (një) ambient, ku shtron veprimtarinë e shërbimit të lavanderisë.

Per sa me sipër operatori ekonomik te paraqes nje deklarate perkatese sipas formatit te meposhtem:

Nr.	Vendodhja	Statusi
1		Pronesi/qira/perdorim

Vendodhja qe do te deklarohet detyrimisht do ti paraqitet Autoritetit Kontraktor per te qene pjese e planit te zbatimit te kontrates.

- Krahas deklarates te paraqes akt miratimi higjens - sanitar per kete ambient, lëshuar nga organi kompetent i ngarkuar me ligj.

Shënim 2.1:

Në zbatim të ndryshimeve të reja ligjore Operatorët ekonomikë për ambientin që ushtron aktivitetin duhet të paraqesin pranë AK jo më vonë se 5 dite nga publikimi i njoftimit të fituesit, dokumentacion që vërtetojnë pronësinë, ose qiramarrjen, ose huapërdorjen (certifikatë pronësie/kontrata qiraje / kontrata huapërdorje / çdo dokument tjetër me anë të të cilit fitohet e drejta e pronësisë ose përdorimit sipas Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë).

3. Operatori Ekonomike duhet të deklarojë se në rast se shpallet fitues, do të realizoj ambientin për të realizuar shërbimin e lavanderisë në ambientet e Autoritetit Kontraktor sipas përcaktimeve në Specifikimet Teknike.
4. Operatori/ët ekonomik pjesëmarrës për të realizuar shërbimin objekt prokurimi, duhet të ketë minimalisht 11 (njëmbëdhjetë) persona të punësuar, në profilet sipas tabelës si mëposhtme:

Stafi	Nr.
Drejtuues Teknik- me profil Inxhinier kimist ose Inxhinier mjedisi	1 (një)
Punëtore në Lavanderi	4 (katër)
Punonjës Shërbimi	6 (gjashtë)
Totali i punonjësve	11 (njëmbëdhjetë)

